



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" (Nismë deputeti) (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi , Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi dhe Halit Valteri.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Ardit Konomi dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – Drejtor i Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Trimi – Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane e Tregtisë

Alketa Uruçi – Kryetare e Komitetit të Taksave dhe Doganave, Dhoma Amerikane e Tregtisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, data 11.06.2019, ora 10:30.

Për diskutim kemi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, që është një nismë e deputetit Ilir Beqaj, i cili është dhe relatori i saj. Projektligji ka ardhur në Kuvend në datën 09.05.2019 dhe, meqenëse është një projektligj me efekte financiare, do të kërkojë edhe mendimin e Këshillit të Ministrave, të cilin akoma nuk e kemi, për shkak se komisioni përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe është e drejta e tyre për ta çuar në Këshillin e Ministrave për marrje mendimi.

Sot nuk besoj se do të arrijmë dot ta shterojmë të gjithë diskutimin dhe votimin, por do të bëjmë, por do të dëgjojmë prezantimin e zotit Beqaj për këtë projektligj. Si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kemi ftuar drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, zotin Niko Lera, zotin Fran Brahimi dhe dy përfaqësues të grupeve të interesuara, drejtorin Ekzekutiv të Dhomës Amerikane të Tregtisë, zotin Ilir Trimi dhe zonjën Alketa Uruçi, kryetare e Komitetit të Taksave dhe Doganave pranë Dhomës Amerikane të Tregtisë.

Për informacion unë dhe zoti Beqaj kemi zhvilluar para disa ditësh një takim me përfaqësues të grupeve të interesit, kemi marrë shqetësimet, pretendimet dhe kemi diskutuar për këtë projektligj. Gjithsesi sot po fillojmë diskutimin formal për të kaluar më pas në votimin dhe miratimin në seancën e radhës.

Pa e zgjatur, po ia jap fjalën relatorit dhe deputetit që ka nisur këtë ndryshim, zotit Ilir Beqaj.

Ilir Beqaj - Faleminderit!

Të nderuar kolegë, shtysa për të arritur në këtë propozim ka ardhur nga disa sipërmarrje të ndryshme, pasi ato kanë shprehur shqetësimet e tyre të unë, të cilat në fund të muajit janar të këtij viti, por dhe në vijim, u përballën me një regjim fiskal të ri, relativisht të papritur për ta dhe me rëndesa në funksionimin e bizneseve të tyre. Janë sipërmarrje me të cilat unë dhe një pjesë e kolegëve, që kanë qenë në komision në muajin nëntor, kur diskutuam paketën fiskale, u njohëm me problematikat e tyre, madje, për kujtesë, ne si komision, në fund të diskutimit të paketës fiskale, patëm dalë me propozimin që projektin e qeverisë për uljen ose kalimin e taksimit të plastikës nga taksim ambalazhi, (që deri vjet ishte në fuqi me 100 lekë kg) ta kalonim në lëndë plastike me 35 lekë produkt të gatshëm për import apo me

25 lekë lëndë e parë në të gjitha llojet e produkteve. Nuk e pranua dhe kërkua që të diferencuhej. Siç e dimë të gjithë, seanca plenare, që ka vullnetin e plotë, nuk e miratoi propozimin tonë dhe ai hyri në fuqi.

Por çfarë ndodhi me fillimin e zbatimit të këtij ligji? Dua të sjell në vëmendjen tuaj një shqetësim, që e kam ngritur që në momentin e parë! Po marr si ilustrim shishen plastike të ujit me 0.5 litra. E kam hequr enkas etiketën se nuk ka lidhje me prodhuesin, por me të gjithë historinë. Kjo shishe vjet shitej me shumicë në Shqipëri me 24 lekë, nëse marrim një normë fitimi 20%, prodhuesit i kushtonte 20 lekë. Vetë prodhuesit na patën shpjeguar këtu që vetëm ambalazhi plastik ishte 52 % e kostos së ujit, që do të thotë se këtë ambalazh plastik, nëse vjet e taksonim 100 lekë për kilogram dhe plastika me gjithë taksimin shkonin në 52%, këtë vit e taksojmë ose kur vjen e gatshme apo gjysmë e gatshme me 35 lekë, ose kur vjen lëndë e parë dhe prodhohet këtu si ambalazh plastik, taksohet me 25 lekë.

Pra e kemi ulur 3 deri në 4 herë. Normalisht kjo shishe nuk duhet të ishte më shumë se 17.5 lekë, duke zbritur taksën, që se paguajnë më dhe duke mbajtur po atë normë fitimi. Nuk është më pak se 21 lekë me shumicë. Praktikisht ajo politikë fiskale e miratuar vjet pas propozimit të Ministrisë së Financave, sipas shpjegimeve të dhëna këtu prej saj, nuk shkoi te konsumatori, nuk uli përdorimin e kësaj shisheje, se kjo ka impakt drejtpërdrejt në mjedis, dhe ngeli të sipërmarrësit. Administrimi i vjetshëm nuk ishte aq efektiv për të bërë dallimin mes materialit plastik apo ambalazhit plastik, që në Shqipëri importohet 10 lekë lëndë e parë për ambalazh plastik dhe dilte në treg 9 lekë.

Në atë kohë e patëm ngritur këtë shqetësim në Ministrinë e Financave, e cila, me të drejtë, tha, që në fund të fundit, ata bëjnë kontrollet e tyre fiskale, por nuk funksionojnë si Komisioni i Planit të Shtetit, që të diktojnë çmimet në treg. Për më tepër filloi të vihej re mënyra se si ishte hartuar dispozita dhe mënyra se si zbatohet nga administrata jonë doganore. Filluan të taksoheshin në mënyrë të papritur boja plastike me të cilat lyhen muret te ne, sepse lënda e parë me të cilën prodhohet sot boja në Shqipëri, dhe, për fat të mirë, boja nuk importohet më e gatshme nga Greqia, por këtu, bënte pjesë në një nomenklaturë, që, sipas Kodit Doganor, duhet të përfshihej në taksime. Përveç bojës janë edhe dritaret plastike, të cilat ne duam t'i nxisim t'i përdorin në funksion të eficiencës së energjisë, papritur rezultuan më të shtrenjta. Sa për ilustrim: çfarë ka ndodhur nga muaji shkurt e këtej? Kur plastika importohet si lëndë e parë kushtonte me të gjithë vlerën e importit, me të gjithë barrën fiskale në doganë 123 lekë për kilogram, nga muaji shkurt ka shkuar në 140 lekë, pra është 20% më e shtrenjtë kostoja e lëndës së parë. Tubat plastike nga 180 lekë për kilogram metri linear kanë shkuar në 205 lekë, pra 13.8 lekë më shtrenjtë kostoja e lëndës së parë.

Bojërat plastike që ju ilustrova, kilogrami nga 136 lekë ka shkuar në 161 lekë, duke u shtrenjtuar me 18% kostoja e lëndës së parë, sfungjeri, që përdoret për prodhimin e kolltukëve e karrigeve nga 185 lekë për kilogram ka shkuar në 210 lekë për kilogram, duke shkuar 13.5% kostoja e lëndës së parë, polisteroli, që përdoret kryesisht në ndërtim për struktura të lehta mes kateve apo për termoizolim ka shkuar për kilogram nga 70 lekë në 95 lekë, duke u shtrenjtuar kostoja e lëndës së parë me 5,7% dhe kjo ka filluar të japë efekte edhe në çmimin fundor të produkteve. Një metër linear tub plastik ka shkuar 153 nga 122 lekë, 25,4% më shumë. Një litër bojë, e cila mesatarisht përdoret për të lyer 5 metra katrorë mur, ka shkuar 460 nga 400 lekë, 15% më shumë. Një metër kub polisterol, që përdoret në ndërtim, ka shkuar 6 mijë e 600 lekë për metër kub nga 5 mijë e 900, 12% më shumë. Nga njëra anë ne kemi një politikë me programet e zhvillimit të bujqësisë, që e subvencionojmë serrën dhe plastmanin e saj, por nga 300 lekë për 50 metër katrorë, e kemi shtrenjtuar plastmanin në 350 lekë, 16,7% më shumë çmimi fundor. Dritarja plastike që thamë, ka dy nivele, një që është më ekonomike dhe metri katror i ka shkuar 130 euro nga 115 euro, 30% më shumë, dhe një që është në cilësi më të mirë, që ka shkuar 180 euro metri katror nga 155 euro, 16% më shumë.

Pas diskutimeve me disa nga këta sipërmarrës, që, siç e thashë, i kemi njohur në diskutimet e paketës fiskale gjatë nëntorit, të cilët, me aq sa kam informacion, kanë kontaktuar me qeverinë, me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen dhe Sipërmarrjen, nuk e di deri në cilën fazë kemi arritur në përfundimin se projektligji ka tri momente:

Përpiqet të ulë barrën e re fiskale në tri grupe edhe me arsyetimin që vërtet plastika ndikon në mjedis, por një tub plastik, pjesë e instalimeve hidraulike apo mekanike të një ndërtese të re, është një ndërtesë për gjithë jetën, jo si një shishe plastike që merret dhe hidhet. Një dritare plastike, e vendosur në një godinë, është gjithë jetën me godinën, madje me një eficiencë energjie indirekt për të ngrohur apo ftohur këtë mjedis, konsumohet më pak energji e prodhuar, dhe për rrjedhojë ka më pak efekt karboni nga prodhimi i një energjie të pakësuar në mjedis. Tubat që përdoren në sistemet e furnizimit me ujë vërtet janë material plastik, por janë të trupëzuara aty. Historia e bojës që, nëse nuk do ta prodhojmë këtu, do të vijë bojë plastike. Përbërja e plastikës në bojën e gatshme është e tillë, e vogël, sepse nuk taksohet boja e gatshme, ndërsa lënda e parë, nëse boja do të prodhohet këtu, taksohet. Ne kemi 3-4 vjet që nuk importojmë bojë të gatshme, por e përpunojmë këtu me lëndë të parë, por duhet të rikthehemi ku ishim.

Praktikisht ka tri grupe që përpiqen të rregullohen: të lehtësojë barrën e taksimit të lëndëve të para për prodhimin e artikujve të plastikës, duke ndërhyrë vetëm në lëndët e para

që importohen, nga 25 lekë në 10 lekë, duke mos e lëvizur 35 lekëshin e taksës mbi plastikën e importuar si produkt të gatshëm. Në rastin e eksportimit të produkteve që prodhohen këtu, të mos rimbursohet prodhuesi vetëm për ambalazhin e eksportuar, por edhe për një produkt plastik që eksportohet, si dhe të përjashtojë nga pagesa e taksës lëndën e parë primare. Këtë term e kemi gjetur bashkë me sipërmarrësit në rastet që kapitullin 39, për mbetjet e plastikës në import, kur lënda plastike që vjen, përdoret, është pjesë e një procesi teknologjik, por nuk prodhon produkt të gatshëm plastik.

Në vlerësimet paraprake që unë kam mundur të bëj, duke marrë të dhëna historike nga Ministria e Financave, ulja e nivelit të taksës për lëndët e para primare, nga 25 lekë në 10 lekë, duhet të ketë një efekt 200 deri në 225 milionë lekë në vit. Këtë vit, nëse dispozita do të hyjë në korrik apo në gusht, do të jetë një efekt pakësues në buxhetin e shtetit, rreth 100 milionë lekë të rinj. Këtë vit është 200-225 milionë lekë për 12 muaj. Nëse do të miratohet në korrik, do të jetë jo më shumë se 100 milionë lekë. Për vitet e ardhshme do të ketë sigurisht ngarkesën e plotë.

Ndërkohë, të shprehur me dispozita, e keni të shtjelluar në nenet ku ndërhyhet. Jemi përpjekur të bëjmë edhe një saktësim të polesteroli, sipas terminologjisë që e kanë kërkuar sipërmarrësit, sepse, kur vjen momenti i zbatimit nga administrata doganore, kërkon të jetë sa më precize, sepse nuk do që nesër një hapësirë, që mund të jetë interpretim i një terminologjie, të krijojë mundësi për vlerësime të diskutueshme, diskutime biznesi, që mund të krijojnë hapësira për trajtime të diferencuara, që krijojnë konkurrencë të pandershme. Për momentin mendoj se është e logjikshme kjo që thashë për të parashtruar projektin.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kalojmë në pyetjet tuaja, apo të dëgjojmë edhe ...

Si mendon?

Vazhdojmë me pyetje ose komente nga anëtarët e komisionit.

Zoti Baraj e ka kërkuar fjalën.

Besnik Baraj – Kur janë bërë mbledhjet për buxhetin na bente përshtypje rezistenca jo aq e pjesës së administratës se sa drejtuesve të administratës, sepse edhe të ardhurat në buxhet për këtë ndryshim nuk ishin të rëndësishme dhe, ndërkaq, shikonim efektin negativ në prodhimin vendas që shfrytëzonte lëndën e parë. Parimisht jam totalisht në mbështetje të zotit Ilir. Iliri e përmendi, dhe unë mendoj se është paradoksale të thuash që kjo taksë është për të kufizuar përdorimin e plastikës, sepse, nëse vlera e taksës së shisheve plastike do të qëndronte 100 lekë, mund të thosha. Ndërkaq, lënda e parë plastike të bëhej nga zero në 25 lekë, do të ishte koherente, por ta ulësh nga 100 lekë në 35 lekë dhe më pas të shtosh për lëndën e parë, është paradoksale.

Nga ana tjetër, Ministra e Financave parimisht ka qenë inkoherente në qëndrimet e veta. Në ç'kuptim? Kur vjen puna në eksportin e kromit, politikat e Ministrisë së Financës kanë qenë të arsyeshme për mua, të kufizohej eksporti i lëndës së parë, që të shfrytëzohej lënda e parë në vend për të rritur vlerën e shtuar të produktit, politikë që përgjithësisht e ndjekin të gjitha vendet e zhvilluara dhe më duket racionale.

Nga ana tjetër, kur ne sillnim argumentin se lëndën e parë që po vjen nuk duhet ta taksojmë për të stimuluar prodhimin vendas dhe për të rritur vlerën e shtuar të produkteve që krijohen në vendin tonë, nuk e pranonin. Nga pikëpamja parimore, për mua ka probleme në qëndrime dhe në arsyetime.

Në finale, dua të shtroj pyetjen: a mund të na thoni sa janë imputet në buxhet për këtë ndryshim që bëtë?

Krahas asaj që tha Iliri, është i panumërt numri i produkteve që janë prekur nga kjo ndërhyrje, që nga këpucët, karriget e të tjera. Iliri përmendi disa, që për mua duhet patjetër të rikonsiderohen.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Valteri.

Halit Valteri – Faleminderit, zoti kryetar!

E mbështes zotin Baraj, por kam një pyetje. Si do të zëvendësohen në buxhetin e shtetit 200-225 milionë lekë të rinj, ose 100 milionë? Ka parashikuar buxheti i shtetit si do të bëhen investimet, si do të bëhet shpërndarja e këtyre të ardhurave? Janë 200-225 milionë lekë të rinj në vit. Është shumë mirë që po ua ulim prodhuesve, sepse i nxisim, por a është parashikuar si do të zëvendësohen këto lekë, apo kemi menduar se, duke i ulur, do të rritet më shumë prodhimi dhe konsumi?

Ilir Beqaj – Ju keni shumë të drejtë, sepse praktikisht në buxhetin e vitit 2019 janë të përfshira 200-225 milionë lekë. Unë nuk kam bërë një aritmetikë të detajuar, por thelbi i përgjigjes sime u tha në pjesën e fundit të asaj që thatë ju. Praktikisht, bizneset që përmenda e kanë ulur sot xhiron e tyre me 30%-40%. Automatikisht, ajo çfarë ka humbur buxheti, qoftë si TVSH nga rënia e xhiros, edhe si të ardhura fiskale, tatim në burim për të punësuarit, kontribute për të punësuarit dhe tatim-fitimi i mundshëm që do të pakësohet, e kompensojnë atë që thatë ju, sepse kanë qenë të ardhura që i merrte vjet. Pra, vërtet po merr 225 milionë lekë më shumë këtë vit, por tashmë, me prova, po merr më pak nga ajo që ju thatë, sepse kjo ka sjellë ulje të qarkullimit të tyre ekonomik.

Kryetar, për atë që tha kolegu Baraj, nëse nuk do të kisha qenë pjesë e diskutimit në nëntor, unë nuk do ta kisha bërë këtë propozim, sepse, në parim, jam kundër përjashtimeve. Përgjithësisht përjashtimet krijojnë deformime në treg, vështirësi në administrim, hapësirë për

marifete, rrisin arbitraritetin e administratës që merret me zbatimin, krijojnë hapësirë edhe për konkurrencë të pandershme, por efekti konkret, që u prodhuan nga ndryshimet tona të ligjshme të diskutimit të nëntorit, më bëri të marr përsipër të vij me këtë propozim.

Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – I nderuar koleg, lind pyetja: pse nuk i keni menduar këto 6 muaj më parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zotëri, edhe nëse unë nuk isha këtu, isha poshtë në treg.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Përgjithësisht unë nuk jam i shpejtë në të menduar, jam i ngadaltë, dhe më është dashur koha ime e nevojshme.

E para, ligji, në mos gaboj, hyri në fuqi më 20-25 janar, sepse ky burri që bëri antimiting dje në mëngjes, ka filluar të bëjë antimitingje kundër maxhorancës që në dhjetor, sepse e vonoi pa arsye të gjithë paketën fiskale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai që bëri antimitingun në 8:00 të mëngjesit në fillim të bulevardit.

Po ky burrë ka filluar që në dhjetor t'i krijojë probleme maxhorancës dhe zbatimin e buxhetit e vonoi qëllimisht që të krijonte pakënaqësi. Është pjesë e veprimeve konstante, sepse pas asaj të djeshmes nuk i drejtohem më me titullin që ka.

E dyta, bizneset i ndeshën efektet në muajt shkurt dhe mars, e ngritën shqetësimin në prill, mua m'u desh, me ngadalësinë time të zakonshme, koha e nevojshme për të menduar dhe e kam propozuar në datën 9 maj. Pra, nuk m'u deshën gjashtë muaj, por një muaj e gjysmë. Herën tjetër do të përpiqem të jem pak më reaktiv.

Halit Valteri - Ajo që po thoshte zoti Gjuzi ishte "sa seriozë jeni", sepse i bëni ligjet dhe i anuloni më vonë. Nuk është problemi që po ulim taksën, sepse kjo është gjë e mirë, por sepse e sillni përsëri pas gjashtë muajve për ta anuluar.

Ilir Beqaj – Në mos gaboj, rreth viteve 1870, një kryeministër anglez, Benjamin Disraeli, ka thënë një shprehje që mua më pëlqen shumë dhe që e sjell gjithmonë edhe me vete: "Në një shoqëri që ndryshon, ndryshimi është konstant". Do të thotë që ne prandaj jemi këtu deputetë dhe prandaj Shqipëria është republikë parlamentare dhe jo e ndonjë lloji tjetër, siç mund të mendojë dikush tjetër dhe ta shprehë këtë edhe me dekrete. Ngaqë jemi republikë parlamentare, ne si komision kemi ngritur një shqetësim në muajin nëntor, kemi bërë një amendament, por, sigurisht, si çdo demokraci parlamentare i bindemi vullnetit të shumicës. Prandaj, në datën 30 qershor do të shkojmë të votojmë për zgjedhjet vendore, sepse ka një vullnet shumice që është i mishëruar në institucionet demokratike të shtetit shqiptar.

Po në funksion të këtij vullneti të shumicës, unë, si një deputet, individ, në bazë të asaj çfarë rregullat e bashkëjetesës demokratike, për të cilat ne investojmë prej 20 vjetësh, kanë sjellë, bëj këtë propozim. Sigurisht, jeni ju fillimisht dhe më pas vullneti i shumicës në seancë që e mbështet, e rrëzon, e amendon e të tjera. Që në datën 9 maj jam njësoj si dëgjuesit në këtë rast.

Niko Peleshi – Sipas radhës fjalën e kanë Valteri, Baraj, Gjuzi.

Halit Valteri – Zoti Beqaj, a keni kontaktuar me grupet e interesit kur është bërë ky ligj? Nga informacionet që kam, prodhuesit e plastikës kanë katër muaj që deklarojnë vështirësi shumë të mëdha, pothuajse humbje nga kjo gjë. Po kostot e humbjeve si pasojë e këtij ligji kush i merr përsipër, sepse këta njerëz po falimentojmë? Nga perioda që e keni ndryshuar këtë dhe deri tani kush i merr përsipër kostot, shteti, Ministria e Financave, njerëzit që kanë bërë këtë ligj apo i mban biznesi mbi kurriz?

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Me këto biznese kemi diskutuar në muajin nëntor këtu në komision. Kemi edhe procesverbalet për të parë se çfarë kanë thënë të gjitha palët e interesuara.

E dyta, e rëndësishme është që kjo pjesë e projektligjit nuk krijoi diferencime në biznes gjatë zbatimit të saj. Pra, ishte një masë e rëndësishme për të përdorur politikën fiskale në përgjithësi si një instrument për të kontrolluar përdorimin e plastikës në Shqipëri për pasojat që ajo ka në mjedis.

Duhet të kemi parasysh se janë tre qëllimet kryesore për të cilat përdoret politika fisklave: për të krijuar të ardhura për shtetin, për të realizuar ai funksionet e tij të domosdoshme që lidhen minimalisht me rendin publik, sigurinë kombëtare dhe shëndetin publik, për të bërë politikën e rishpërndarjes (unë besoj se rishpërndarja në Shqipëri në këto 6 vjet ka arritje të mrekullueshme) dhe pastaj për t'u përdorur si instrument për të nxitur apo frenuar një gjë të caktuar. Për shembull, ne kemi rritur akcizën e duhanit dhe kjo është reflektuar në uljen e përdorimit të duhanit në nivel mesatar në Shqipëri.

Mund të jetë krijuar problem në ekonomi, por nuk ka krijuar konkurrencë të pandershme. Nga informacionet që unë kam, kanë ardhur të gjithë në bllok. Propozimi që unë bëj këtu ka një element pak më të prirur kombëtar, sepse në momentin që diferencimi import i gatshëm apo lëndë e parë ishte 35/25, unë propozoj të bëhet 35/10, propozim, të cilin nuk e di nëse do ma pranojë Komisioni i Integritetit, sepse në bazë të MSA-së, aq më shumë kur këto ditë ne presim të marrim përgjigje pozitive, duket si një lëvizje kundër saj. Ndryshe nga produkti i gatshëm, lënda e parë, nga sa na kanë shpjeguar këtu në nëntor, ka rreth 10% firo.

E dyta, nga lënda e parë deri në prodhim ka një kohë më të gjatë dhe kosto paraje, sepse taksa paguhet që në doganë edhe kur është lëndë e parë. Taksa ndikon drejtpërdrejtë në

llogaritjen e TVSH-së që paguhet në doganë. Komunikimet me biznesin janë të vazhdueshme. Ne si komision kemi fatin që mbulojmë ndoshta rreth 60% të jetës ekonomike të vendit me miniera, rrugë, telekomunikacion, porte, mjedis, turizëm, tregti, aviacion.

Besnik Baraj – Ka shumë direktiva në Bashkimin Europian që miratohen dhe pësojnë amendime shumë shpejt si pasojë e dinamikës dhe reflektimit të tyre në ekonominë e vendeve të ndryshme. Uroj që të keni jetë sa më të gjatë në jetën parlamentare dhe vetë ju do të jeni iniciatorë të ndryshimeve të ligjeve që po ju vetë i keni miratuar, por që jo çdo gjë mund të parashikohet.

Niko Peleshi - Po, zonja Gjermani.

Kujtim Gjuzi – Kryetar, e kisha radhën unë, por për respekt ndaj zonjave, mund të vazhdoj.

Niko Peleshi – Më falni!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Unë dua ta falenderoj kolegun Beqaj për nismën, për shpjegimin e detajuar, për faktin që ka diskutuar me grupet e interesit, për impaktin pozitiv që mund të ketë nisma, sidomos duke stimuluar prodhimin vendas, në mënyrë të veçantë për sa i përket lëndëve të para për përdorimin për eficiencë energjie. Besoj se e gjithë kjo punë apo nismë do të ketë impakt pozitiv edhe te pjesa e ndërtimeve me eficiencë energjie, që ne e kemi marrë si angazhim si me ligjin e eficiencës së energjisë edhe me parametrat e Bashkimit Europian.

Unë kam një pyetje për kolegun Beqaj, meqenëse gjatë prezantimit të tij përmendi faktin që me ndryshimet që u bënë në paketën fiskale konsumatorët nuk përfituan në mënyrë të drejtpërdrejtë. Si e garantojmë ne që me këtë nismë apo me këto ndryshime impakti pozitiv do të ndihet jo vetëm nga sipërmarrësit, por edhe nga konsumatorët Shqiptarë? Për mua është shumë e rëndësishme të ulet çmimi dhe qytetarët të përfitojnë direkt nga kjo. E garantojmë dot? Marrim skenarin pozitiv sikur Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni i Integrimit do ta votojnë. Pra, si do ta ndjejnë këtë impakt qytetarët?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë mendoj se nuk mund të japim garanci.

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, kryetar!

Nëse më lejon zonja Gjermani, dua të them që këtu jemi të gjithë ekonomistë dhe kemi mësuar për avantazhet dhe disavantazhet në një lëvizje teknike financiare. Në këtë kontekst, kur ka ulje të çmimit të produktit, gjithmonë fitojnë qytetarët, sepse tregtari i iks

artikulli është i detyruar të ulë çmimin. Pra, kjo është politikë e djathtë dhe unë e falenderoj zotin Beqaj që ka ardhur afër politikave të djathta.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke mos qenë specialist i kësaj fushe, unë jam dakord me debatet që bëhen dhe nuk dua ta trajtoj politikisht.

Për sa i përket diskutimit politik, unë mendoj që zgjedhjet duhet të bëhen në 30 qershor, pasi jam në krye të gjashtë partive që kandidojnë nga ana e opozitës. Pra, të mos trajtojmë këtë çështje politikisht, por të flasim për të mirat që sjell kjo nismë. Politikisht le ta trajtojnë si të duan, kurse unë jam dakord për këtë formë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Para se t'ju jap fjalën grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dua të bëj një përmbledhje për të qartësuar edhe mediat. Zoti Beqaj, më korrigjoni nëse gabo!

Pra, po diskutojmë për tri kategori mallrash: ambalazh plastik i gatshëm, lëndë të para primare dhe lëndë të para primare që përdoren për mallra jo plastikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Në qoftë se ambalazhi i kësaj shisheje uji ka një taksë kur importohet, nëse kjo shishe uji do të eksportohet, taksa e ambalazhit do të rimbursohet. Ligji e ka vetëm për ambalazhet, kurse unë propozoj që të rimbursohet edhe taksa kur është një produkt i gatshëm plastik që eksportohet.

Pra, lënda e parë është eksportuar kur ka hyrë në Shqipëri, është prodhuar një produkt plastik, është taksuar, prodhohet një produkt plastik i gatshëm dhe ky eksportohet. Pra, edhe taksa që është paguar me hyrjen e lëndës së parë të rimbursohet siç rimbursohet vetëm për ambalazhin sot.

(Diskutime pa mikrofon.)

Besnik Baraj - Në qoftë se një karrige është në masën 90% prej druri dhe 10% plastikë, a do të pasqyrohet kjo në rimbursim?

Ilir Bejtja – Sipas propozimit tim, kur kjo karrige eksportohet, nuk rimbursohet.

Besnik Baraj - Besoj se duhet të dalë një rregullore për këtë.

Niko Peleshi – Pra, jemi në situatën që me paketën e vitit 2018 për ambalazhin ka qenë 100 lekë/kilogram, por me paketën fiskale të vitit 2019 u bë 35 lekë/kilogram.

Amendamenti e lë 35 lekë/kilogram për ambalazhin plastik, kurse për lëndët e para ka qenë 0 lek.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nikolla Lera – Në vitin 2018 nuk ka pasur taksë për lëndët e para primare.

Niko Peleshi – Pra, ka qenë 0 dhe u bë 25 lekë me paketën fiskale të vitit 2019, kurse në amendament propozohet që të bëhet 10 lekë. Për lëndët e para, për prodhime jo plastike ka qenë 0 lek dhe me paketën fiskale të vitit 2019 u bë 25 lekë. Pra, nuk kishte diferencim dhe amendamenti e lë përsëri me 0 lek.

Fjalën do ta marrin përfaqësuesit e Dhomës Amerikane të Tregtisë. Me sa kam kuptuar edhe nga biseda e mëparshme, sepse ata do ta thonë këtë shqetësim, por unë po mundohem ta përmbledh, në qoftë se me paketën e vjetër fiskale ne nuk bënim diferencime të dukshme ndërmjet importimit dhe prodhimit vendas kishte vetëm një diferencim nga 35 lekë në 25 lekë. Grupet e interesit nuk e kanë çmuar si një ndryshim të madh, duke futur këtu edhe frot në procesin e prodhimit. Pra, ata thoshin se nuk diskriminohej importi, por tani duket sikur, siç e tha edhe zoti Beqaj, që lehtësohet më tepër prodhimi vendas, në njëfarë mënyre indirekte diskriminohen mallrat e importit. Ky është shqetësimi bazë, apo jo? Pra, në parim duhet t'i qëndrojmë vetëm qëllimit primar të reduktimit të mbetjeve apo do të duhet të pranojmë edhe këtë amendament, i cili jo vetëm ndikon në reduktimin e mbetjeve, por ndikon edhe në nxitjen e prodhimit vendas? Këtu besoj se jemi, pak a shumë, në këtë linjë.

Fjala për ju.

Alketa Uruçi – Përshëndetje!

Faleminderit, zoti Peleshi!

Shpjegimin në fakt ne e kemi dërguar edhe në një dokument me shkrim para komisionit me disa komente dhe sugjerime të anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe shqetësimi kryesor i ngritur në këtë projektligj ka lidhje vetëm me një aspekt. Pra, projektligji ka tri elemente:

E para, rimbursimi i taksës së produkteve plastike në rastet kur produktet eksportohen.

E dyta, importi i lëndëve të para, që përdoren për prodhimin e produkteve që kanë plastikë brenda, por nuk janë materiale plastike. Për këtë nuk kemi asnjë koment apo sugjerim, përkundrazi komentet e anëtarëve tanë kanë qenë që komisioni duhet ta bëjë këtë miratim, pasi pjesa e produkteve dhe e lëndëve të para plastike për prodhimin e produkteve joplastike ka qenë një shqetësim. Kjo është rregulluar në njëfarë mënyre me një udhëzim të ministrit të Financave, por ka nevojë edhe për një ndërhyrje ligjore, në mënyrë që të jetë më e qartë dhe më e specifikuar.

Komentet e anëtarëve tanë kanë lidhje me uljen e taksës së aplikuar për lëndët e para, me të cilat prodhohen materiale plastike apo ambalazhe plastike brenda vendit. Ashtu siç e përmendi edhe zoti Peleshi, importi i produkteve plastike dhe importi i ambalazheve plastike taksohet që nga janari i vitit 2019 me 35 lekë/kilogram. Ndërkohë që lëndët e para, të cilat përdoren për ambalazhet plastike apo për produktet plastike taten me 25 lekë/kilogram. Në atë kohë diferencimi u realizua me propozim nga qeveria për faktin se kishte firo teknologjike në prodhim. Rrjedhimisht, me ndryshimin nga 35 lekë/kilogram në 25 lekë/kilogram po barazojmë në njëfarë mënyre efektin në çmimin final të konsumatori të produkteve plastike dhe ambalazheve plastike, që importohen të gatshme, me ato që prodhohen në vend. Në këtë kuptim, një diferencim i tillë duhet të bazohet te norma reale e firove, por ka kuptim dhe nuk diskriminohen produktet e importit.

Ndryshimi tjetër i propozuar për këtë projektligj ishte për uljen e taksës së ambalazheve për lëndët e para nga 25 lekë/kilogram në 10 lekë /kilogram. Ky qëndrim i anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë ka të bëjë me një trajtim diskriminues të produkteve të importit. Kjo sepse bën një ndërhyrje të panevojshme në treg, ndërhyrje në konkurrencën e ndershme ndërmjet bizneseve, të cilat paguajnë tatime si ato që prodhojnë produkte plastike në vend apo prodhojnë ambalazhe plastike në vend, edhe ato që importojnë produkte plastike apo ambalazhe plastike të gatshme. Rrjedhimisht legjislacioni fiskal nuk duhet të ndërhyjë që t'u japë trajtim favorizues prodhuesve vendas kundrejt atyre të importit. Ky është një angazhim që jo vetëm qeveria, por edhe parlamenti shqiptar e ka marrë me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian në nenin 34, ku merr përsipër që do të ndalojë diskriminimin fiskal për produktet e një pale kontraktore. I njëjti rregull vlen edhe për marrëveshjet e tregtisë së lirë, që Shqipëria ka nënshkruar jo vetëm me vendet e rajonit, por me marrëveshjen CEFTA, EFTA e të tjerë.

Edhe para vitit 2019 Bashkimi Europian ka ngritur shqetësimin për rastet kur ligji i jep trajtim favorizues prodhimit vendas kundrejt produkteve të importit. Ky ishte edhe një nga shkaqet pse në paketën fiskale të vitit 2019 u parashikua që të hiqet taksa 1 lek për recikluesit. Pra, në atë kohë kishte një diferencim 100 lekë për ambalazhet dhe 1 lek për recikluesit dhe me kërkesat e vazhdueshme të BE-së kjo gjë u hoq, në mënyrë që të mos kishte më diferencime të tilla.

Ne i kemi paraqitur edhe zotit Peleshi një rast nga legjislacioni italian, i cili parashikon aplikimin e taksës për ambalazhet dhe produktet plastike. Në këtë legjislacion parashikohet që taksa për lëndët e para duhet të jetë e njëjtë me taksën për produktin e gatshëm. Kjo sepse firoja në prodhimin e materialeve plastike, të paktën të ambalazheve plastike, është shumë e ulët. Pra, nuk justifikohet ndryshimi 35 lekë me 10 lekë që ne duam ta

përfshijmë. Nëse komisioni juaj dhe Kuvendi gjykojnë se duhet incentivuar prodhimi i plastikës në vend, atëherë zgjidhja e ndershme do të ishte që e njëjta ulje, që parashikohet për prodhuesit vendas, të parashikohet edhe për importuesit e ambalazheve plastike dhe lëndëve të para, në mënyrë që të kemi një treg shitjeje konkurrues, pa diskriminime për importuesit apo pa diskriminime favorizuese për prodhuesit vendas.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj - Në fakt, për humor, fushat magnetike të politikave të Presidentit të Amerikës, me sa duket, për proteksionizëm pasqyrohen edhe këtu te ne.

Unë kam një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, dhe për të qenë koherent me atë që thashë më parë unë do të isha dakord që lënda e parë të ishte jo 10 lekë por 0 lekë. Kur bëhet fjalë për tuba hidraulikë, sigurisht është një produkt, i cili, sikurse e tha zoti Ilir, mbetet në ndërtesë dhe nuk sjell ndonjë problematikë në kontaminimin e plastikës në vend, kurse kur vjen puna për të prodhuar ambalazhe të kësaj natyre, dhe në këtë mënyrë ndoshta kënaqim pak edhe përfaqësuesit grupet e interesit që kanë ardhur këtu, në vend, kjo duhet të këtë një taksë mjedisore në mënyrë që të përdoret si fond për të minimizuar efektin në mjedis të kësaj plastike apo kështu është? Pra, kur prodhohet shishja këtu, a taksohet kjo në finale si produkt?

Niko Peleshi – Po , zoti Lera.

Nikolla Lera - Atëherë, këtë skemë, që sapo ju thatë, ne e kemi pasur para dhjetorit të vitit 2018. Ne kemi kërkuar që të taksohej me 100 lekë/kilogram ambalazhi që importohet dhe 100 lekë/kilogram ambalazhi që prodhohej brenda vendit. Pra, 100 lekë i kërkohej edhe importuesit, edhe prodhuesit vendas, ashtu siç thatë ju. Pse e prezantuam këtë ndryshim? Sepse në 12 vjet të implementimit të këtij ligji, ndërkohë që në import paguhej 100 lekë/kilogram ambalazhi plastik nga llogaritjet me lëndën e parë të importuar të kthyer në produkt, nga pagesa e taksave të paguara na rezultoi se niveli mesatar i taksës për prodhimin e vendit është 5,7 lekë. Pra, i nderuar deputet, ne kemi një diferencë prej 94% më të vogël, krahasuar me atë të importit, dhe ky ishte një nga shkaqet kryesore që ne e ndërmorëm këtë reformë. Problemi madhor ishte mungesa e taksave në këto përmasa dhe ky problem duhej të adresohet. Në këtë mënyrë u krijua edhe një problem i vogël, sikurse ju e thatë, për taksën e këpucës, por nuk mund të lejonim që t'i humbim të ardhurat në këto nivele. Cila ishte rrugëzgjidhja? Rrugëzgjidhja ishte që të zgjerohej baza e taksimit, pra të taksohej një nomenklaturë më e gjerë mallrash, përveç shisheve plastike, sepse e provuam në 12 vjet, që donim të taksonim vetëm ambalazhin e prodhimit vendas dhe arkëtonim 5,7 lekë/kilogram. E keqja nuk mbaronte këtu, por ky ambalazh, i cili prodhohej dhe nuk taksohej, shkonte te

prodhuesit e produkteve ushqimore dhe të produkteve të tjera. Kjo gjë nxiste evazionin dhe mosraportimin në këto subjekte. Këto mallra, që prodhonin këta, shkonin tek tregtarët me shumicë dhe pakicë, gjë që nxiste mosraportimin nga ana e tyre. Pra, krijohet një zinxhir i tërë evazionit, i cili duhet të adresohet dhe ne e adresuam, duke ndërmarrë një sërë masash.

Në radhë të parë, ne e ulëm nivelin e taksës nga 100 lekë në 35 lekë, pra me 2/3-at, e cila duhet të reflektohet, sikurse e tha edhe deputeti Beqaj, në uljen e çmimit me pakicë për konsumatorin. Në këtë mënyrë u reduktua kostoja që zinte ambalazhi, e cila më parë shkonte deri në 51%.

Ne krijuam edhe avantazhin krahasues me prodhimin vendas, duke e caktuar 25 lekë, pra nivelin e kësaj takse e ulëm rreth 30%. Ne nuk duhet të gënjejmë që do ta administrojmë këtë taksë për ambalazhin, sepse u përpoqëm 12 vjet dhe nuk ia arritëm dot. Unë ju thashë se sa ishte niveli i arkëtimit të saj. Natyrisht që u krijuan disa probleme të vogla, në kuptim të zbatimit të kodit të nomenklaturës së taksimit dhe të produkteve që nuk janë produkte plastike, sepse ligji thotë që do të taksohen produktet plastike, por ato u adresuan me aktin nënligjor, sepse ishin plotësisht brenda ligjit, një pjesë e tyre.

Për shembull, unë dua të korrigjoj deputetin Beqaj për bojërat. Bojërat u adresuan, sepse nuk e paguajnë këtë taksë dhe nuk ka asnjë arsye të rritet çmimi I shitjes së tyre për konsumatorët, sepse do të ishte spekulativ. Mund të ketë pasur probleme në 2-3 javët e para të janarit, por jo më tej. Kështu na ngelen pa u adresuar disa lloje produktesh, sikurse janë polisterolet, të cilat hynin në kodet e plastikës dhe që janë adresuar me propozimet që bën deputeti në fjalë.

Ndërkohë, kishim parashikuar duke gjykuar se kishte vetëm eksport produktesh ushqimore, të cilat ambalazhohen. Ne donim të nxisnim eksportin e lëngjeve, eksportin e ujit, eksportin e produkteve bujqësore apo blegtorale të paketuara në ambalazhe plastike dhe për të nxitur këto vendosëm edhe mekanizmin e rimbursimit të kësaj takse që ishte paguar kur kishte ardhur si lëndë e parë, por nuk kishim dijeni të plotë që kishte edhe prodhues produktesh plastike në vend.

Le të themi, ka kompani që importojnë lëndën e parë dhe prodhojnë lugë dhe pirunë plastikë për eksport. Natyrisht, e kuptuam që duhet t'i kishim parashikuar edhe ato dhe jemi të lumtur që deputeti i ka futur në grupin e atyre që duhet t'u bëhet rimbursimi.

Kam edhe diçka lidhur me efektet. Efektet pak a shumë janë në këtë nivel që përmendi deputeti Beqaj, pra rreth 250 milionë lekë. U tha këtu që ka pasur mbyllje të bizneseve, rritje të kostove 15, 20 apo 30% e të tjera gjëra. Nëse efekti i uljes nga 25 në 10 është maksimalisht 250 milionë në vit ose rreth 2,2 milionë dollarë, sepse këtë e kanë konfirmuar grupet e interesit që ishin në Kuvend, e kanë konfirmuar shoqatat e tyre

përfaqësuese në takimet me Ministrinë e Financave, janë rreth 500 operatorë që operojnë, atëherë llogaritet që kostoja vjetore që rritet për shkak të kësaj takse është 4000 dollarë për një subjekt. 4000 dollarë rritje kostoje vjetore, që ta pjesëtosh me muaj apo me prodhim, nuk e di sa shkon, rrit koston totale me 25%? Këto janë të dhëna që nuk përputhen me realitetin.

Nuk dua të pranoj dhe jam i bindur që impakti i kësaj takse con në mbylljen e bizneseve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Niko, ti dhe unë kemi shumë vite që merremi me shifra dhe për pasojë na duhet të flasim edhe me përqindje. Sigurisht, nga këndvështrimi i detyrës që bën ti, këto biznese mund të jenë më pak se 1% e bizneseve, por ai biznesi vetë për hallin e vet është 100%. Ai që merret me produkte plastike, atë ka gjithë jetën e vet dhe ai 100%-i s'do t'ia dijë fare as për statistikat e tua, as për përqindjet e mia. Për sa kohë u konstatua që, në zbatim e sipër, kishte edhe prekje të ciklit të biznesit do të duhej të ndërhyt.

E dyta, ajo që ne ua thamë qysh atëherë dhe prapë është dhe mbetet problematike përgjithësisht në politikat tona fiskale, është parashikueshmëria.

Të merresh me biznes, të kesh lidhur një kontratë, të furnizosh dhe me 20 janar, papritur, kur shkon për të bërë zhdoganimin të dalë që nga 1 lek taksë duhet të paguash 5 lekë taksë, e vë realisht sipërmarrjen përpara një vështirësie.

Unë nuk dua të tregoj ndonjë lloj protagonizmi, por do të depozitoj nesër në Kuvend një amendament për ligjin që keni sjellë për procedurat tatimore.

Jam dakord me atë që ju keni thënë se çdo biznes që është i deklaruar për TVSH mbi 2 milionë lekë të reja duhet të ketë llogari bankare, por nuk jam dakord që kjo të hyjë në fuqi në mes të korrikut, kur njerëzit kanë ikur me pushime. Në amendament do të propozoj që hyrja në fuqi të mos jetë 2 javë, por të jetë në datën 1 janar, sepse më shumë krijojmë telashe. Edhe ju në administrim do të keni telashe, sepse inspektori do të ketë detyrë të vërë aktin e konstatimit, do të krijojë një gjobë, do të krijojë pakënaqësi dhe nuk besoj se për 4-5 muaj spostimi i zbatimit të këtij ligji do të japë ndonjë anomali shumë të madhe. Prandaj them se edhe koha e nevojshme për informim është element shumë i rëndësishëm. Unë besoj se për ju që merreni përditë me fiskun është shumë i domosdoshëm edhe besimi që tatimpaguesit krijojnë ndaj shtetit, por sidomos ndaj administrimit, rregullave të administrimit.

Në fakt, kolegu Baraj e tha me humor, por unë realisht do t'i kërkoja Dhomës Amerikane të Tregtisë të ndjekë edhe politikën tregtare të SHBA-së sot, sepse është shtet anëtar i OBT-së.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Musai!

Nimet Musaj - Faleminderit!

Duke dëgjuar me vëmendje kolegun, mendoj se është një nga pikat më të rëndësishme që e vlerësoj këtë nismë (jo vetëm sot por edhe për të ardhmen), prandaj kërkoj mbështetjen nga të gjithë kolegët që të kalojë në parim me këto propozime, por do të ulemi përsëri shumë shpejt, sepse duke e njohur sektorin fason, mund t'ju sugjeroj se rënia e euros ka arritur në atë pikë që edhe këto biznese po shkojnë drejt falimentimit.

Ka pasur rimbursim të TVSH-së, që lë për të dëshiruar. Duhet të gjenden momente të caktuar për ta kaluar në një kohë të caktuar rimbursimin në forma dhe metoda nga më të ndryshmet, duke i kthyer këto vlera edhe në pagesa të sigurimeve shoqërore të këtyre bizneseve. E njoh mirë këtë sektor dhe ndoshta në të ardhmen do të vi edhe me një amendament të caktuar që tu vijmë në ndihmë për periudha të caktuara kohe, siç bëmë edhe me dividendin, me qëllim që t'u vijmë në ndihmë këtyre bizneseve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Lera!

Niko Lera – Lidhur me situatën e fasonëve është e vërtetë ajo që thoni ju se kursi i këmbimit ka ndikuar në performancën dhe në gjendjen financiare të tyre, por ne jemi të kënaqur që edhe gjatë vitit 2018, kur filloi rënia e kursit të këmbimit, edhe në vitin 2019, kemi një rritje krahasuar me periudhën paraardhëse të eksporteve nga përpunimi aktiv me 10, 15 dhe 20%, që do të thotë se rritja e volumit të punës e ka amortizuar uljen e kursit të këmbimit. Realisht, me të njëjtin kurs këmbimi si janari i vitit 2018, rritja e eksporteve do të ishte në nivelin 30%, por është në nivelin 10-15% për shkak të kursit të këmbimit.

Lidhur me rimbursimet ka pasur problematika. Ne e kemi adresuar dhe ju deklaroj këtu se në fund të muajit qershor kërkesat për rimbursim të grupeve prioritare, sikurse janë fasonët, ta kemi numrin një të prioriteteve. Do të përfundojë numri i kërkesave të vonuara dhe nga muaji korrik 2018 dhe në vijim ne do të jemi në respektim të ligjit duke rimbursuar këto kategori brenda afatit ligjor. Pra, pas qershorit merr fund vonesa në rimbursimin e fasonëve dhe eksportuesve, të cilët përkundrejt kërkesave do të rimbursohen sipas ligjit brenda 60 ditëve nga data e miratimit të kësaj kërkesë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Nikolla Lera - Faleminderit!

Është e vërtetë se ka një rritje të importeve, por unë dua t'ju them se në Shqipëri, ndoshta pas 25 vjetësh, kanë ardhur firmat më prestigjioze, si Dolce & Gabbana, OGAN e të tjera, të cilat biznesi i ka pasur ëndërr të ishin në Shqipëri.

Mendoj se duhet t'u krijojmë këtyre firmave kushte dhe mundësi që kjo pjesë që i ka munduar gjithë këto biznese me fitimin, të cilin e përmendi kolegu Beqaj, se në fund të fundit secili nga këto biznese bën hesapin e vet, se po të kishin kurs tjetër, të ardhurat e tyre do të ishin më të mëdha, kështu që edhe të ardhurat e shtetit do të ishin shumë më të mëdha se sa janë sot, sepse kursi ka penalizuar edhe bizneset, edhe qeverinë.

Në të ardhmen e afërt do t'ju sugjeroja të gjejmë një rrugë të mesme për ta kaluar këtë situatë të rëndë të bizneseve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Niko, meqenëse u hap kjo temë, do t'ju sugjeroja të bënit një analizë më të thelluar të asaj që thatë, sepse fakti mund të jetë i vërtetë dhe nuk e vë në dyshim, sepse e keni të raportuar, por ajo është një sipërmarrje shumë intensive, që do të thotë se, nëse volumi është rritur 20% dhe euroja është nënçmuar 13%, nuk jemi zero me zero, sepse është një sipërmarrje ku fuqia punëtore zë mbi 70%.

Në këto 2-3 vjet minimalisht rritja e pagës minimale në shkallë vendi ndikon te piramida e pagave edhe në ato biznese, që kryesisht janë me paga të ulëta, pavarësisht se të dhënat e INSTAT-it dje raportnin që në 3 vjet, mesatarisht, pagat janë rritur me 10-15% në Shqipëri, por kjo është një sipërmarrje ku ka shumë kosto fuqi punëtore, e cila nuk ndikohet nga euroja.

Ndoshta duhet një analizë më e thellë për vetë kontributin e qenësishëm që ky lloj aktiviteti ka, qoftë në punësim, qoftë në bilanc tregtar.

Niko Peleshi – A ka ndonjë koment tjetër?

A kanë diçka për të shtuar përfaqësuesit e Dhomës?

Dakord. Atëherë unë propozoj që ta mbyllim këtu, pra të mos vazhdojmë me miratimin, sepse nuk jemi komision përgjegjës, por jemi për dhënie mendimi, ndërkohë që është Komisioni i Ekonomisë që do të ndjekë procedurën me Këshillim e Ministrave, pra ta çojë për mendim atje dhe ne të bëjmë një seancë tjetër pasi të kemi marrë mendimin e KM-së përmes Komisionit të Ekonomisë.

Siç u tha këtu edhe nga deputeti Valteri e të tjerë, duhet të dimë se sa të mundur e ka edhe buxheti i shtetit të kompensojë atë shkurtim që ky amendament i jep apo ç'mendime të tjera mund të kenë, megjithëse zoti Lera ishte goxha i qartë në të gjitha përgjigjet që dha, pavarësisht se cili është qëndrimi, por, të paktën, nga ana e Ministrisë së Financave tani e dimë qasjen.

Nikolla Lera – Në sqarimin tim unë nuk doja të diskutoja propozimin për uljen e nivelit të taksës. Ajo është një vendimmarrje politike, por unë doja të sqaroja gjithë panoramën se pse është ndërmarrë kjo politikë dhe cilat kanë qenë rezultatet e saj.

Niko Peleshi – Si korçar që je, je shumë i kalkuluar.

Faleminderit!

Takohemi në seancën tjetër.

MBYLLET MBLEDHJA